




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



TV Dukagjini
Dardan Belegu
Drejtor
Prishtinë



VENDIM

Lidhur me Rastin 2024/7– Ankesa e z. Korab Bokshi i autorizuar i z. Afrim Caka (Palë ankuese) për TV Dukagjini (Pala Përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë, i cili ka hyrë në fuqi me datë 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM, me datë 15 dhjetor 2023 ka pranuar një ankesë nga Pala ankuese, të cilën e ka drejtuar edhe te Pala përgjegjëse, ndaj emisionit “Debat Plus” me titull “Kërcënimet e Vuçiqit” i transmetuar në Palën përgjegjëse me datë 28 shtator 2023, me pretendimin se janë transmetuar deklarime publike të pavërteta dhe fyese nga panelisti z. Dardan Gashi, ndaj z. Caka. Pala ankuese kërkon që në të njëjtin emision të bëhet demanti nga z. Dardan Gashi si vijon: “Deklarimi im lidhur me z. Caka në emisionin “Debat Plus” të datës 28 shtator 2023 ka qenë shpifje”. Po ashtu, Pala ankuese kërkon edhe nga Pala përgjegjëse që në po të njëjtin emision të kërkojë falje për lejin e gjuhës ofenduese dhe për mos tërheqje të vërejtjes panelistit z. Gashi.
3. KPM, me datë 21 dhjetor 2023, me qëllim të sqarimit të pretendimeve ankimore të Palës ankuese, ka kërkuar nga Pala përgjegjëse që të sjellë sqarim lidhur me ankesën në fjalë.
4. KPM, me datë 26 dhjetor 2023 ka pranuar përgjigje nga Pala Përgjegjëse përmes së cilës theksohet se “Sa i përket kërkesës së palës ankuese që Pala përgjegjëse t’i kërkojë falje z. Caka, Pala përgjegjëse nuk e sheh të arsyeshme që për këtë pretendim të ngritur nga pala ankuese të kërkojë falje. Pala përgjegjëse pret që Pala ankues të kërkojë falje për gjuhë fyese dhe linçimin që ka bërë ndaj emisionit “Debat Plus”, autorit të emisionit, stafit të emisionit dhe panelistëve të rregullt të emisionit “Debat Plus”. Një gjë e tillë nuk është e pranueshme të bëhet nga ana e askujt ndaj një emisioni specifik por edhe ndaj mediave në përgjithësi.”
5. KPM ka analizuar ankesën e Palës ankuese, përgjigjen e Palës përgjegjëse, ka bërë monitorimin e kronikës dhe bazuar në Raportin e monitorimit të datës 11 janar 2024 ka gjetur

se Pala përgjegjëse në emisionin “Debat Plus” të datës 28 shtator 2023 është përdorur gjuhë ofenduese, duke lejuar përdorimin e fjalës “Zagar” ndaj z. Caka, veprim ky në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 3, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

6. KPM pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datë 24 janar 2024, i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim për shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar që në afat prej shtatë (7) ditëve, t’i ofrojë të drejtën e reagimit Palës ankuese, siç përcaktohet me nenin 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
7. Për të vërtetuar se a i është ofruar e drejta e reagimit Palës ankuese nga Pala përgjegjëse, KPM me datë 13 shkurt 2024 i ka dërguar një e-mail Palës ankuese duke e pyetur se a është kontaktuar nga Pala përgjegjëse dhe se a i është ofruar e drejta e reagimit.
8. Me datë 13 shkurt 2024, KPM ka pranuar përgjigje nga Palas ankuese, i cili ka theksuar se: *“Ju njoftoj që deri në momentin e përgjigjes përmes këtij email, nuk jemi kontaktuar dhe nuk na është dhënë mundësi e reagimit nga Pala përgjegjëse, d.m.th, nuk jemi kontaktuar as unë dhe as z. Caka personalisht.”*

Analiza ligjore

9. Komisioni, bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin nenit 4, paragrafi 3, dhe nenit 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
10. KPM bazuar në Raportin e monitorimit të datës 11 janar 2024 ka konstatuar se Pala përgjegjëse në emisionin “Debat Plus” të datës 28 shtator 2023 ka dështuar që të ndërmarrë veprimet e duhura për evitimin e përdorimit të gjuhës vulgare dhe ofenduese, duke vepruar në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 3, të Kodi të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, i cili përcakton se:
“Në programet e drejtpërdrejta (debate/intervista etj), është obligim i OSHMA-së që të ndërmarrë veprimet e duhura për evitimin e përdorimit të gjuhës vulgare dhe ofenduese nga ana e pjesëmarrësve.”
11. Ndërsa, sa i përket të drejtës së reagimit, KPM-së ka konstatuar se Pala përgjegjëse edhe pas Njoftimit për shkelje nuk e ka transmetuar reagimin e Palës ankuese, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:
“Me qëllim të korrektësisë dhe paanshmërisë duhet të ofrohet mundësia që brenda shtatë (7) ditësh pas paraqitjes së ankesës së individit apo organizatës, të transmetohet reagimi përkatës në mediumin e njëjtë. Reagimi duhet të transmetohet në kohë dhe hapësirë të njëjtë.”
12. KPM, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 4, paragrafi 3, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, si dhe me mos transmetimin e reagimit të Palës ankuese ka bërë shkelje të nenit 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Vendim

13. Pala Përgjegjëse, sanksionohet me Vërejtje në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 4, paragrafi 3, dhe nenit 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM 2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.
14. Pala përgjegjëse obligohet që në afat prej shtatë (7) ditësh, pas pranimi të këtij Vendimi, t'i ofrojë Palës ankuese të drejtën e reagimit në hapësirë të njëjtë dhe në kohë të njëjtë, në mënyrë që të veprojë në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03

E drejta për ankesë

15. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
16. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Jeton MEHMETI
Kryetar



15.04.2024
Datë